 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<b>Politika për programin e Akreditimit.</b>	<b>Kodi: DA-PO-015</b>
		<b>Rishikimi nr 3</b> <b>Dt: 14.11.2024</b>
		<b>Faqe 1 nga 6</b>

## 1. Qëllimi

Në këtë dokument detajohet politika e DPA në lidhje me mënyrën e formulimit të programit të akreditimit për skemat e akreditimit që DPA ofron. Kjo politikë aplikohet gjithashtu edhe me synimin për të përcaktuar burimet dhe ekspertizën teknike që do të aplikohet për vlerësimin e një OVK.

## 2. Fusha e veprimit.

Kjo politikë zbatohet tek të gjitha llojet e vlerësimeve të OVK për të saktësuar programin e akreditimit. Bazuar në politikën DA-PO-004, DPA nuk akrediton për fushë fleksibël.

## 3. Referencat

Politika e DPA bazohet në:

DA-PO-002 “Politika e akreditimit”

ILAC-G29:06/2020 Udhëzues për harmonizimin e fushave të akreditimit sipas ISO/IEC 17025 për laboratorët WADA anti-doping

IAF ID 1:2020 Dokument informative i IAF për fushat e akreditimit të QMS dhe EMS.

## 4. Formulimi i programeve të Akreditimit për Laboratorët e Testimit dhe Kalibrimit.


Përgjithësisht, formulimi i programeve të Akreditimit për Laboratorët e Testimit dhe Kalibrimit bëhet duke u bazuar në ILAC-G 18. Formulimi i programit për laboratorët mjekësorë duhet të bëhet në përputhje me EA 4/17. Formulimi i programit për laboratorët anti-doping do të kryhet në përputhje me ILAC G 29.

DPA vlerëson vetëm metodat testuese të mirënjohura (përfshi edhe kalibrimin). Programet janë formuluar mbi bazën e formularit të aplikimit të dërguar nga aplikanti. Programi për laboratorin është dhënë në DA-FO-022 i cituar tani e më tutje.

DPA akrediton laboratorët testues mbi bazën e metodave standarde kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.

Kur është e nevojshme. DPA bën akreditim edhe mbi bazën e standardeve të tjerë kombëtarë të mirënjohur në fushën e sektorëve industrialë si, ASTM, ASHRAE, ARI, (SMEDP) –Metoda Standarde për Kontrollin e Bulmetrave, AOAC, etj.

Kur standardet kërkojnë sqarime ose hollësi të mëtejshme, janë fushat e aplikimit ato që japin identifikimin e metodës “ të brendëshme”.

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<b>Politika për programin e Akreditimit.</b>	<b>Kodi: DA-PO-015</b>
		<b>Rishikimi nr 3</b> <b>Dt: 14.11.2024</b>
		<b>Faqe 2 nga 6</b>

Ndaj metodave të botuara në manuale të ndryshëm, DPA do të kërkonte të njëjtat identifikime.

Pa patur informacione të tjera nga ana e laboratorit, DPA do të konsideronte që aplikimi është kërkuar për versionin e fundit të metodës të testimit dhe fusha e vlerësimit do të jetë përgatitur sipas procedurës DA-PT-015 të DPA.

Tregohet sistematikisht data e botimit të çdo metode standarde ose të “brendëshme”.

Kur laboratori dëshiron që të akreditohet sipas një metode standarde të mëparëshme atëhere kjo metodë do të konsiderohej si “metodë e brendëshme”

Metodat e brendëshme: Kur laboratori aplikon për akreditim sipas metodës së testimit të bazuar plotësisht mbi një metodë testimi standarde, kjo shënohet në programin e akreditim, me referimin ndaj Standardit dhe numrin shoqërues të “metodës të brendëshme”. (Për shëmbull , EN 71-3 IP 002:2019).

Modifikimet dhe përditësimet e metodave të testimit si edhe aktivitetet e ndërmarra që përfshijnë paraqitjen e rezultateve të përfuara ose të të dhënave të tjera të rëndësishme ( p.sh rezultatet e vlerësimeve) duhet të kontrollohen dhe mirëmbahen të rregjistruara. Këto të dhëna do ti ofrohen DPA sipas kërkesës të saj.

Aplikanti duhet të saktësojë nëse akreditimi është kërkuar për metodat e testimit që ai kryen në vendndodhjen e tij ose jashtë vendndodhjeve të tij, ose në të dyja. Kjo gjë shënohet në programin e akreditimit.

Vendndodhje: Kur DPA akrediton kompetencën e një laboratorit për të kryer teste jashtë vendndodhjeve të tij kjo do të paraqitet në fushën , në një kollonë të veçantë si psh “ Kodi i vendndodhjes” të Laboratorit ose në teren ose tjetër si “ Kategoria” 0 për rastin brenda laboratorit, 1- për rastin në teren ose 2- për të dy njëherësh.


## 5.1 Skema e Testimit dhe Kalibrimit.

Formulimi i programit të akreditimit për skemën e testimit dhe kalibrimit bazohet në dokumentin ILAC-G18.

### 5.1.1 Shprehja e programit të akreditimit të laboratoreve testues.

Minimalisht rekomandohet që programet e akreditimit të përmbajnë elementët që vijojnë :

(a) Identifikimi i produkteve (grupit të produkteve), materialeve ose objekteve të testuara.

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<b>Politika për programin e Akreditimit.</b>	<b>Kodi: DA-PO-015</b>
		<b>Rishikimi nr 3</b> <b>Dt: 14.11.2024</b>
		<b>Faqe 3 nga 6</b>

- (b) Identifikimi i testeve specifike ose i llojeve të testeve që kryhen (parametri që matet)
- (c) Identifikimi i standardeve ose metodave të përdorura për testimin
- (d) teknikën e provës ku bazohet testimi.
- (e) fusha e matjes dhe/ose e provës.

Në programin e akreditimit, jepet informacion nëse laboratori është i akredituar për dhënie opinionesh /intepretimesh apo për marrje mostre. Në rastet kur laboratori akreditohet për marrje mostre në programin e akreditimit vendoset standardi/metoda kundrejt të cilit është akredituar.

Shprehja e programit të akreditimit për laboratorët mjekësorë bëhet sipas EA 4/17.

Në rastin e laboratorëve mjekësorë, fusha e aplikimit dhe programi i akreditimit shprehen si në tabelën më poshtë:

Nr.	Materiali / Sistemi / Matrica, e testimit	Analiz/Parametri	Teknika	Pajisjet /Referenca e metodes /e procedures
1	Psh. serum	IgM anti-Antitruapat e toksoplazmës	ECLIA (Analiza imunologjike e elektrokimilumineshencës)	Emri i IVD-MD (pajisja) PSO Ref. xx
2				

Në rastin e POCT (point-of-care testing), akreditimi i laboratorit mjekësor do ti referohet standardit, EN ISO 15189:2022.

Në lidhje me POCT (point-of-care testing) fusha e aplikimit dhe programi i akreditimit shprehen si në tabelën më poshtë:



Tel: +355 4 22 69097  
+355 4 22 69325  
Fax:  
E-Mail: info@dpa.gov.al

## Politika për programin e Akreditimit.

Kodi: DA-PO-015

Rishikimi nr 3  
Dt: 14.11.2024

Faqe 4 nga 6

Vendi/pika e dorëzimit	Materiali/Sistemi/Matrice	Analiza/Parametri	Teknika	Pajisjet /Metoda /Procedura Referenca
Psh. Spitali A / reanimacion kirurgjikal	Gjak	Gazrat e gjakut: pH, pCO2	Metoda potencio metrike	Emri i pajisjes PSO Ref. xx

### 5.1.2 Shprehja e programit të akreditimit për laboratorët kalibrues

Shprehja e programit të akreditimit për laboratorët kalibrues bazohet në dokumentin ILAC G 18.

Minimalisht rekomandohet që programet e akreditimit të përmbajnë elementët që vijojnë:


- objekti/instrumenti që kalibrohet ose materiali referues
- Identifikimi i kalibrimit
- Identifikimi i fushës së kalibrimit
- Identifikimi i standardeve ose metodave të përdorura për kalibrimin
- Identifikimi i teknikës së kalibrimit
- Pasiguria në matje

DPA mund të përfshijë edhe informacion tjetër në programin e akreditimit të laboratorëve kalibrues si psh. Opinione/ interpretime, kodi i vendndodhjes, etj).

### 5.2 Formulimi i programit të akreditimit për organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit

Programi i akreditimit për organet certifikuese të sistemit të menaxhimit të cilësisë, sistemit të menaxhimit të mjedisit dhe të sigurisë së jetës dhe shëndetit në punë do të formulohet sipas IAF ID 1.

Shprehja e programit të akreditimit për sistemin e menaxhimit të cilësisë për organet e certifikimit të pajisjeve mjekësore do të bazohet në IAF MD 8.

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<b>Politika për programin e Akreditimit.</b>	<b>Kodi: DA-PO-015</b>
		<b>Rishikimi nr 3</b> <b>Dt: 14.11.2024</b>
		<b>Faqe 5 nga 6</b>

Shprehja e programit të akreditimit për organet certifikues të sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore do të bëhet me kategori dhe nënkategori sipas standardit ISO 22003-1.

Shprehja e programit të akreditimit për organet certifikuese të sistemit të menaxhimit të energjisë do të bëhet me kategorinë e përcaktuar në standardin ISO 50003:2014. (shënim, akreditimi do të bazohet në standardin ISO 50003:2021).

Shprehja e programit të akreditimit për organet certifikues të sistemit të menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit do të bëhet me grupe sipas udhëzimit të DPA, DA-IN-006.

Shprehja e programit të akreditimit për organet certifikues të cilët do të akreditohen sipas skemave të certifikimit ISO 27001, ISO 20000-1, ISO 37001, ISO 39001, ISO 27701, ISO 28001, ISO 20121 do t'i referohet standardit përkatës.

Shprehja e programit të akreditimit për organet certifikues të cilët do të akreditohen sipas skemave të certifikimit ISO 27001, përveç standardit përkatës, DPA do të përfshijë shprehjen "të gjitha kodet IAF".

### 5.3 Fusha për organet inspektuese

Shprehja e programit të akreditimit për organet inspektues jepet sipas tabelës së mëposhtme:


Nr	Materiali ose sistemi që do të inspektohet	Tipi i inspektimit (psh: periodik, fillestar, etc)	Standardi ose metoda e inspektimit

### 5.4 Fusha për organet e certifikimit të personave

Programi i akreditimit për organet certifikuese të personave përban informacionin në lidhje me personat ose grup personat, skemën e certifikimit dhe titullin e skemës. Fusha e aplikimit dhe programi i akreditimit shprehen sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Personat ose grupi i personave	Standardi ose dokumenti tjetër normativ	Titulli i standardit ose dokumentit normativ

### 5.5 Shprehja e fushës së akreditimit për organet e certifikimit të produkteve, shërbimeve dhe proceseve

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<b>Politika për programin e Akreditimit.</b>	<b>Kodi: DA-PO-015</b>
		<b>Rishikimi nr 3</b> <b>Dt: 14.11.2024</b>
		<b>Faqe 6 nga 6</b>

Fusha e akreditimit për produktet, shërbimet dhe proceset do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Produktet, shërbimet ose procesi që do të certifikohen
- Specifikimi për produktin, shërbimin ose procesin – dokument(et) që përmbajnë kërkesat për konformitetin e produkteve, shërbimeve ose proceseve
- Procedura e certifikimit – dokument që përshkruan metodat/procedurat për certifikim.

Për të përshkruar dhe strukturuar fushën e akreditimit DPA plotëson fushën e akreditimit me treguesin e kodeve të akreditimit IAF ID 1

### 5.5.1 Shprehja e fushës së akreditimit për GLOBALG.A.P. v 6.0

#### EAC 1 Produkte nga Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkimi

Produkti/Ssherbimi/Procesi	Kriteret e certifikimit	Procedura e certifikimit
Sigurimi i integruar i fermës-Bimët	GLOBALG.A.P. rregullore të përgjithshme V6 Smart dhe/ose GFS Parimet dhe kriteret IFA v6 Smart për frutat dhe perimet Parimet dhe kriteret IFA v6 Smart për lule dhe zbukurime Parimet dhe kriteret IFA v6 GFS për frutat dhe perimet	GLOBALG.A.P. GLOBALG.A.P. Rregullore të përgjithshme V6 Smart dhe/ose GFS Parimet dhe kriteret IFA v6 Smart për frutat dhe perimet Parimet dhe kriteret IFA v6 Smart për lule dhe zbukurime Parimet dhe kriteret IFA v6 GFS për frutat dhe perimet Procedura e certifikimit të OVK
Zinxhiri i kujdestarisë	GLOBALG.A.P. A.P. Rregullore të përgjithshme V6 Smart dhe/ose GFS Parimet dhe kriteret e CoC	GLOBALG.A.P. Rregulloret e Përgjithshme V6 Smart dhe/ose GFS Parimet dhe kriteret e CoC Procedura e certifikimit të OVK

Nëse aplikimi për akreditim përfshin vetëm opsionin 1, kjo do të përshkruhet në objekt. Nëse përfshin opsionin 2, asgjë nuk referohet, pasi nënkuptohet se të dyja opsionet janë përfshirë.

Fushëveprimi mund t'i referohet kufizimeve territoriale

**Drejtori i Përgjithshëm**

**Data: 14.11.2024**

**Pranvera FAGU**